



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TË ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E POLITIKAVE DHE STRATEGJIVE TË ZHVILLIMIT TË ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË

Nr. 4689 Prot.

Tiranë, më 1.9. 2021

Lënda: Për zhvillimin e praktikës profesionale në profesionin e rregulluar të mësuesit për vitin mësimor 2021-2022.

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
Rruga "Aleksandër Moisiu"
Tiranë

DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

ZYRËS VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Në zbatim të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Udhëzimit nr. 30, datë 12.09.2018 "Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar", i ndryshuar dhe Urdhrit nr. 336, datë 14.07.2011, "Për miratimin e Rregullores "Për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit", i ndryshuar, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar zhvillojnë procedurat për organizimin dhe zhvillimin e praktikës profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit.

Kandidatët që do të pranohen në praktikën profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit janë të gjithë ata kandidatë që plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 57, të ligjit 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Profili ku kandidati do të kryejë praktikën profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit lidhet me programin e studimit të ciklit të parë.

Për vitin shkollor 2021-2022, afati i regjistrimit të kandidatëve për zhvillimin e praktikës profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit është nga data 13.09.2021-20.09.2021.

Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar, deri në datën 24.09.2021, dërgojnë në DRAP-et përkatëse, listën e praktikantëve sipas tabelës bashkëlidhur shkresës.

Drejtoria Rajonale të Arsimit Parauniversitar hartojnë listat përfundimtare me kandidatët aplikantë në format Excel për të gjitha Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar nën

juridiksion dhe, brenda datës 27.09.2021, i dërgojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar.

Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dërgon brenda datës 30.09.2021 listat përfundimtare të kandidatëve, zyrtarisht me postë dhe në rrugë elektronike në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Praktikanti paraqitet në IAPP për të filluar praktikën profesionale në datën 27 shtator 2021 dhe e përfundon atë në datën 24 qershor 2022.

Procedurat e aplikimit për praktikën profesionale të bëhen në përputhje me Urdhrin nr. 336, datë 14.07.2011 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit”, të ndryshuar.

ZVAP-et të marrin masa, që përveç pikave të përshkruara në rregullore, praktikantët paraqesin edhe dokument banimi në rajonin e tyre si dhe fotokopje të noterizuar të diplomës së ciklit të parë dhe të dytë në fushën e edukimit. Praktikantët zhvillojnë praktikat profesionale në IAPP sipas emërimit në diplomën përkatëse.

ZVAP-të janë përgjegjëse për saktësinë e të dhënave të pasqyruara në tabelën bashkëlidhur si dhe për respektimin me rigozitet të kërkesave dhe të afateve të përcaktuara si më sipër.

Procesi i organizimit dhe zhvillimit të praktikës profesionale është objekt monitorimi nga MASR-ja, DPAP-ja dhe DRAP-të.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Alqi KUSHI

